



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr. 153 dt.22.11.1995

Këshilli Bashkiak i qytetit të Tiranës, pasi shqyrtoi relacionin e Seksionit të Tregtisë dhe Industrisë Ushqimore “Mbi rritjen e pagës së Këshillit Drejtues të Ndërmarrjes së Tregut të Lirë”, mbështetur në V.K.M. Nr.253, dt.22.05.1995 “Për ndryshimin e pagës mesatare për efekt kontrolli”, si dhe në ligjin Nr.7592, dt.10.06.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e Pushtetit Lokal”,

**VENDOSI**

1. Paga e Drejtorit të Ndërmarrjes së Tregut të Lirë të jetë 9.000 lekë në muaj.
2. Nëndrejtorit të paguhet 10% më pak se drejtori.
3. Kryetar dege apo përgjegjës të paguhen 13% më pak se drejtori.
4. Antarët e tjerë të Këshillit Drejtues të paguhen 15 – 20% më pak se drejtori.
5. Kjo pagë të llogaritet që nga data që është rritur paga e punonjësve të tjerë të ndërmarrjes.

**KRYETARI**

**BESNIK PETRELA**